


Aksidentet Rrugore

Maj 2020

Tiranë, më 18 Qershor 2020: Në muajin Maj 2020 numërohen 75 aksidente rrugore nga 115 aksidente të ndodhura në muajin Maj 2019, duke u ulur me 34,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në pesëmujorin e parë të 2020, numërohen 390 aksidente rrugore nga 583 aksidente të ndodhura në pesëmujorin e parë të 2019, duke u ulur me 33,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Maj 2016 – Maj 2020



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Maj 2020, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 86 persona nga 143 që ishte një vit më parë, duke u ulur me 39,9 %. Numri i të aksidentuarve në pesëmujorin e parë të vitit 2020, është 513 persona nga 773 persona, duke u ulur me 33,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Maj 2020, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 10 persona nga 14 persona të vdekur në Maj 2019. Në pesëmujorin e parë të 2020, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 59 persona nga 76 persona në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Maj 2020, aksidentet rrugore, në 92,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25–34 vjeç, duke zënë 32,0 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë ulur me 22,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në pesëmujorin e parë të 2020, aksidentet rrugore, në 18,2 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 21,1 %, krahasuar me një vit më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore

Periudha	Aksidente Gjithsej	Të vdekur		Të plagosur	
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Maj-2019	115	3	11	42	87
Maj-2020	75	1	9	19	57
Ndryshimi vjetor (%)	-34,8	-66,7	-18,2	-54,8	-34,5
Janar–Maj 2019	583	22	54	209	488
Janar–Maj 2020	390	11	48	149	305
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-33,1	-50,0	-11,1	-28,7	-37,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Maj-2019	100	15	13	1
Maj-2020	69	6	10	0
Ndryshimi vjetor (%)	-31,0	-60,0	-23,1	-100,0
Janar–Maj 2019	493	90	70	6
Janar–Maj 2020	319	71	50	9
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-35,3	-21,1	-28,6	50,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Maj-2019	26	31	18	21	8	11
Maj-2020	9	24	12	18	10	2
Ndryshimi vjetor (%)	-65,4	-22,6	-33,3	-14,3	25,0	-81,8
Janar–Maj 2019	123	167	109	110	42	32
Janar–Maj 2020	54	116	64	85	41	30
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-56,1	-30,5	-41,3	-22,7	-2,4	-6,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rugore sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Maj 2019	Maj 2020	Maj 2019	Maj 2020	Jan.-Maj 2019	Jan.-Maj 2020	Jan.-Maj 2019	Jan.-Maj 2020
Shqipëria	115	75	14	10	583	390	76	59
Tiranë	60	38	5	0	264	192	14	14
Durrës	7	5	2	2	53	39	12	12
Shkodër	0	0	0	0	9	6	8	4
Elbasan	8	6	1	2	34	17	9	6
Fier	6	5	3	2	40	35	11	8
Vlorë	7	4	1	0	34	12	4	0
Korçë	6	3	1	0	31	19	5	1
Lezhë	10	6	1	2	61	29	4	6
Berat	3	1	0	1	12	3	2	3
Kukës	2	2	0	0	13	5	1	0
Dibër	0	3	0	0	5	18	4	1
Gjirokastrë	6	2	0	1	27	15	2	4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet në lëvizje, duke rezultuar në të paktën një person të vrarë ose të dëmtuar. Aksidentet në vendin e punës, depo janë të përjashtuara.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit,

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit,

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj,

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).